

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara
Fushata zgjedhore 2011
Periudha 8/05/2011

Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Unë kam audituar pasqyrën (deklaraten) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzimeve për fushatën zgjedhore të Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise , për periudhën 8/04/2011 deri më 8/05/2011.

Pasqyra është përgjegjësi e drejtimit të subjektit zgjedhor Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise bazuar ne librin e llogarive të Partisë dhe të rregjistrin të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjithë transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore, që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtim-pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin ne perputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të vecantë me SNA 800 “Konsiderata të vecanta-Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike” Këto standarte kërkojnë që unë të veprojmë në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të mos përmbajë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumatat dhe informacionet e dhëna në pasqyrën bashkëlidhur. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të Partisë që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumatat dhe deklaratimet në pasqyrën financiare, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura të rëndësishme të bëra nga drejtimi i Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise, si dhe një vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.



Detyra e subjektit zgjedhor Partisa per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Për mendimin tim, pasqyra bashkëlidhur e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise e datës 8.05.2011, është përgatitur në të gjitha aspektet material, në përputhje me kerkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimeve dhe të pagesave , konform me ligjin nr 9228 datë 29/04/2004 i ndryshuar 'Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'

Doranin AGALLIU

Ekspert Kontabel I Rregjistruar



Durres 26 dhjetor 2011